



12515

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

27-6-2022

U D H Ë Z I M

Nr. 21 datë 27.6 2022

**PËR
KUALIFIKIMIN E VAZHDUAR PROFESIONAL TË MËSIMDHËNËSVE TË
KULTURËS PROFESIONALE NË ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 4 të nenit 12 të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, dhe nenit 62 të udhëzimit Nr. 14, datë 27.05.2021 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të AFP, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të AFP dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”.

U D H Ë Z O J:

**Kreu I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHMË**

**Neni 1
Të përgjithshme**

1. Organizimi i kualifikimit të vazhduar profesional të mësimitdhënësve të kulturës profesionale në arsimin dhe formimin profesional (AFP) do të bëhet në përputhje përgjegjësitë, kriteret dhe procedurat e përcaktuara në këtë udhëzim.
2. Proçesi i kualifikimit të vazhduar profesional të mësimitdhënësve të kulturës profesionale në AFP bazohet në parimet e meritës, transparencës, barazisë, korrektësisë, paanshmërisë, fshehtësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

KREU II

**PËRGJEGJËSITË, KRITERET DHE PROCEDURAT E KUALIFIKIMIT TË
VAZHDUAR PROFESIONAL TË MËSIMDHËNËSVE TË KULTURËS
PROFESIONALE NË AFP**

**Neni 2
Shkallët e kualifikimit të mësimitdhënësve të kulturës profesionale dhe kandidatët për
kualifikim**

1. Kualifikimi i vazhduar (atestimi) i mësimdhënësve të kulturës profesionale, me kohë të plotë, realizohet me tre kategori (shkallë) kualifikimi, nga më e ulëta, te më e larta:
 - a) Kategoria e kualifikimit me titull “Mësues i kualifikuar”;
 - b) Kategoria e kualifikimit me titull “Mësues specialist”;
 - c) Kategoria e kualifikimit me titull “Mësues mjeshtër”.
2. Pas emërimit me kontratë pa afat, deri në marrjen e kategorisë, “Mësues i kualifikuar”, mësimdhënësit e kulturës profesionale, me kohë të plotë, mbajnë titullin “Mësues”.
3. Mësimdhënësit e kulturës profesionale të cilët kryejnë procedurat për fitimin e kualifikimit për një kategori më të lartë se ajo që zotërojnë, konsiderohen “kandidatë” për kualifikim.
4. Në institucionet ofruese të AFP, mësimdhënësit kandidatë për kualifikim ndahen në dy grupe:
 - a) Grupi A: Mësimdhënësit e kulturës profesionale (teorike dhe/ose praktike), me kohë të plotë, të cilët kanë të paktën diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlehtëm, në fushat profesionale përkatëse.
 - b) Grupi B: Mësimdhënësit e praktikës profesionale, me kohë të plotë, të cilët kanë shkollim të mesëm profesional, pas të mesëm profesional, ose diplomë të nivelit bachelor, në fushat profesionale përkatëse.

Neni 3

Kërkesat për fitimin e kualifikimit

1. Për të fituar një kualifikim të një kategorie më të lartë, kandidati duhet të plotësojë këto kërkesa:
 - a) Të plotësojë portofolin (dosjen) e kualifikimit sipas kriterëve të përcaktuara;
 - b) Të kryejë çdo vit, të paktën 18 orë (1 kredit) trajnime të akredituara nga AKAFPK ose të njohura nga AKAFPK.
 - c) Të kryejë me sukses provimin e kualifikimit përkatës.

Neni 4

Këkesa dhe pranimi i kandidatëve në kualifikim

1. Procedura për fitimin e kategorive të kualifikimit (atestimit) nga mësimdhënësit e kulturës profesionale kryhet çdo vit kalendarik, në periudhën 1 janar – 15 korrik.
2. Në procedurën për fitimin e kategorive të kualifikimit pranohen të gjithë kandidatët që janë të punësuar si mësimdhënës me kontratë pa afat, me kohë të plotë, në një ofrues të AFP dhe që sipas pikës 4 shkronja a dhe b të Nenit 2, deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës, plotësojnë kriteret e mëposhtme për vjetërsinë e punës me kohë të plotë, si mësimdhënës të kulturës profesionale në AFP.
 - a) të paktën 5 vjet punë, për kategorinë e kualifikimit “Mësues i kualifikuar”;
 - b) të paktën 10 vjet punë, për kategorinë e kualifikimit “Mësues specialist”, si dhe të paktën 5 vjet pas marrjes së kategorisë së kualifikimit “Mësuesi i kualifikuar”;
 - c) të paktën 20 vjet, punë për kategorinë e kualifikimit “Mësues mjeshtër”, si dhe të paktën 10 vjet pas marrjes së kategorisë së kualifikimit “Mësues specialist”;

3. Mësimdhënësit e kulturës profesionale të cilët plotësojnë kriteret për fitimin e një kategorie kualifikimi më të lartë se ajo që zotërojnë, duhet të paraqesin në drejtorinë e ofruesit të AFP përkatëse, në periudhën 1 - 31 tetor, kërkesë me shkrim për të kryer kualifikimin përkatës, në vitin pasardhës.
4. Çdo drejtori e ofruesve të AFP, pasi verifikon kërkesat, duhet të dërgojë zyrtarisht në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA), deri në 20 nëntor, listën emërore, kategoritë e kualifikimit për të cilat kërkojnë atestimin, të dhënat për vitet e punës dhe kontaktet e kandidatëve që kanë aplikuar dhe që plotësojnë kushtet.
5. AKPA, pasi vlerëson dokumentacionin e dërguar nga ofruesit e AFP, dërgon zyrtarisht në Agjencinë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK), deri në 15 dhjetor, listën emërore dhe kontaktet e kandidatëve, të ndara sipas grupeve (pika 4 e nenit 2) dhe kategorive të kualifikimit (pika 1 e nenit 2) për të cilat ata aplikojnë.
6. AKAFPK, deri në 31 dhjetor, njofton (me e-mail) të gjithë kandidatët për fillimin e procedurës së kualifikimit, për hapat që duhet të ndjekin, adresën zyrtare ku duhet të dërgojnë dokumentat dhe afatet përkatëse.

KREU III

PËRGJEGJËSITË, KRITERET DHE PROCEDURAT PËR PORTOFOLIN E KUALIFIKIMIT

Neni 5

Përmbajtja e portofolit të kualifikimit

1. Portofoli i çdo mësimdhënësi të kulturës profesionale, kandidat për çfarëdo kategori kualifikimi, përbëhet nga dy pjesë:
 - a) Pjesa me të dhënat personale;
 - b) Pjesa me përmbajtje profesionale;
2. I gjithë dokumentacioni i portofolit të kualifikimit përgatitet nga kandidati në format elektronik (pdf) dhe dërgohet me e-mail në adresën info@akafp.gov.al dhe brenda afatit të përcaktuar nga AKAFPK, në njoftimin e dhënë sipas pikës 6 të nenit
3. Pjesa e portofolit me të dhënat personale të kandidatit duhet të përmbajë dokumentet e mëposhtme (të skanuara):
 - a) Jetëshkrimin në gjuhën shqipe, sipas formatit të Europass (Shtojca 1).
 - b) Certifikatat e trajnimeve të akredituara të kryera, me kreditet e fituara (të paktën 5 kredite për kategoritë “Mësues i kualifikuar” dhe “Mësues specialist”, si dhe të paktën 10 kredite për kategorinë “Mësues mjeshtër”), sipas pikës 1.b të nenit 4.
 - c) Certifikatat e trajnimeve të tjera, që lidhen me mësimdhënien ose profesionin, të kryera gjatë periudhës së kualifikimit (nëse ka).
 - d) Vërtetime që tregojnë se kandidati është bashkëpunëtor (specialist i jashtëm me kontratë) i AKAFPK (nëse është).
 - e) Dëshmitë e titujve/gradave shkencore të fituara (nëse ka)
 - f) Vërtetimin, nëse ka kryer, në periudhën e dy viteve të fundit, të paktën 3 (tre) ditë stazh (praktikë) në fushën profesionale përkatëse, në një institucion publik apo biznes privat.

Vërtetimi duhet të jetë i vulosur e firmosur nga drejtori i ofruesit dhe nga përfaqësuesi i institucionit/biznesit.

- g) Dëshmi të zotërimit të gjuhëve të huaja (nëse ka);
4. Pjesa me përmbajtje profesionale e portofolit të kandidatit duhet të përmbajë dokumentet e mëposhtme (të skanuara), ku evidentohet edhe emri e mbiemri i kandidatit:
- Planin e mësimdhënies të një lënde teorike profesionale ose të një moduli të praktikës profesionale, që e jep mësim.
 - Plan-ditarin e një seance mësimore teorike, bazuar në mësimdhënien me prezencë fizike dhe atë online, ose plan-ditarin e një seance mësimore praktike me prezencë fizike;
 - Formulimin e një objektivi mësimor specifik, teorik ose praktik.
 - Një instrument për vlerësimin e njohurive ose shprehive të nxënësve apo kursantëve (test teorik me të paktën 5 njësi testi të ndryshme ose listë kontrolli për shprehitë praktike me të paktën 5 kritere vlerësimi);
 - Një material mësimor për nxënësit/kursantët, për një çështje teorike (një faqe A4) ose një udhëzues pune për një aftësi praktike.
 - Një prezantim (në PowerPoint) për një çështje teorike ose praktike (jo më pak se 3 slajde).
5. Dokumentet e listuar në pikën 3 shkronja a d të nenit 5, si dhe në pikën 4 të nenit 5 janë dokumente të detyrueshme, mungesa e të paktën njërit prej tyre e përjashton kandidatin nga procedura e mëtejshme e kualifikimit.
6. AKAFPK, pas përfundimit të afatit të marrjes së dokumenteve të portofolit, shqyrton dokumentacionin dhe informon individualisht kandidatët (nëpërmjet adresës së e-mail: info@akafp.gov.al nëse janë të plota apo është nevoja për plotësime të mundshme.
7. Kandidatët duhet të plotësojnë dhe dërgojnë me e-mail: info@akafp.gov.al në adresën përkatëse të AKAFPK-së, dokumentacionin e munguar brenda 5 ditëve pune nga marrja e njoftimit, në të kundërt, përjashtohen nga procedura e mëtejshme e kualifikimit.

Neni 6

Vlerësimi i portofolit të kualifikimit dhe ankimi

- Vlerësimi i portofolit të çdo kandidati bëhet nga “Komisioni për kualifikimin e mësimdhënësve të AFP” (KKM), i ngritur me urdhër të brendshëm nga Drejtori i Përgjithshëm i AKAFPK.
- KKM shqyrton dhe vlerëson me pikë të gjitha dokumentet e portofolit të kandidatit, sipas rubrikave dhe kritereve të treguara në “Skemën e vlerësimit të portofolit” të Shtojca 2.
- Portofoli i kandidatit vlerësohet maksimalisht me 50 pikë
- Kandidati që fiton më pak se 25 pikë për portofolin përjashtohet nga procedura e mëtejshme për kualifikim;
- Kandidatët njoftohen me e-mail, për pikët e fituara nga vlerësimi i portofolit.
- Kandidatët mund të ankohen për rezultatin e vlerësimit të portofolit, duke dërguar ankesën me e-mail, në adresën përkatëse të AKAFPK-së, info@akafp.gov.al, brenda 3 ditë pune nga njoftimi për pikët e fituara.
- KKM, brenda 5 ditë pune nga përfundimi i afatit të ankimit, shqyrton ankesat dhe njofton kandidatët për rezultatin përfundimtar të vlerësimit të portofolit.

8. KKM protokollon rezultatet e vlerësimeve për portofolet e kandidatëve, si dhe rezultatet përfundimtare pas ankimeve.

KREU IV PËRGJEGJËSITË, KRITERET DHE PROCEDURAT PËR TRAJNIMET E AKREDITUARA TË MËSIMDHËNËSVE TË KULTURËS PROFESIONALE NË OFRUESIT E AFP

Neni 7

Programet e kualifikimit të mësimeve të kulturës profesionale në AFP

1. AKAFPK harton dhe publikon në faqen zyrtare çdo vit, deri në 30 nëntor, programet e kualifikimit të mësimeve të kulturës profesionale të AFP për vitin pasardhës, sipas grupeve (pika 4 e nenit 2).
2. Çdo program kualifikimi, bazohet te Standardet e mësimeve të AFP, përmban njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojnë mësimeve të kulturës profesionale në ofruesit e AFP, si dhe referencat e burimeve përkatëse.
3. Përgatitja e mësimeve të kulturës profesionale për kualifikimin, përmbajtja e trajnimeve të akredituara dhe kërkesat e testit të provimit të kualifikimit duhet t'i referohen programit të kualifikimit përkatës.

Neni 8

Trajnimet e akredituara për mësimeve të kulturës profesionale në AFP

1. Trajnime të akredituara për mësimeve të kulturës profesionale në AFP konsiderohen ato trajnime që janë akredituar nga Komisioni Kualifikimit Mësimeve të Kulturës Profesionale (KKM) dhe janë publikuar në faqen zyrtare të AKAFPK.
2. Duke filluar nga data e miratimit të këtij udhëzimi, trajnime të akredituara për mësimeve të kulturës profesionale të AFP do të konsiderohen edhe ato trajnime që janë akredituar nga "Komisioni i akreditimit të programeve dhe trajnimeve (KAPT)" i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), por që janë të publikuara në faqen e zyrtare të AKAFPK.
3. KKM publikon në faqen zyrtare të AKAFPK kërkesat dhe kriteret që duhet të plotësojnë ofruesit e trajnimeve për të akredituar trajnimet për mësimeve të kulturës profesionale në AFP.
4. Ofruesit e trajnimeve dërgojnë me e-mail, në adresën përkatëse të AKAFPK, kërkesën dhe dokumentacionin e kërkuar për akreditim të trajnimeve, në format elektronik (pdf).
5. Kërkuesi duhet të plotësojë dokumentacionin e kërkuar për akreditim si më poshtë:
 - a) Kërkesën për akreditim të ofruesit të trajnimeve (shtojca 3).
 - b) Të dhënat e ofruesit (emërtimi i subjektit, emri i përfaqësuesit juridik, adresa e postës elektronike, numri i telefonit, linku i faqes së internetit).
 - c) Dokumentacioni juridik (sipas rastit: ekstrakt nga QKB, vendim gjykatë, Vendim i Këshillit të Ministrave, NIPT, statut, akt pronësie ose marrje me qira për objektin ku kryhet trajnimi).
 - d) Dokumentacioni i programit të trajnimit (titulli, objektivat, temat/modulet, kohëzgjatja (kreditet), metodologjitë e realizimit, formati i realizimit: i drejtpërdrejtë apo online).

- e) Dokumentacioni për shkallën e kualifikimit të trajnerëve (jetëshkrimi, diploma, kualifikime shtesë).
- f) Dokumentacioni për infrastrukturën fizike dhe didaktike të realizimit të trajnimit (kushtet e mjedisit të trajnimit, mjetet didaktike).
6. Dokumentacioni i dërguar për akreditimin e trajnimit, shqyrtohet nga KKM brenda 10 ditëve pune.
7. Pasi shqyrton dokumentacionin për akreditimin e trajnimit, KKM njofton me e-mail aplikuesin nëse trajnimi i plotëson ose jo kriteret për akreditim (së bashku me arësyet përse nuk i plotëson kriteret).
8. Aplikuesi për akreditimin e trajnimit, nëse nuk akreditohet, mund të ankohet te KKM, me e-mail, brenda 3 ditëve pune nga marrja e njoftimit. (te shtohet zyrtarisht.)
9. KKM, pasi shqyrton ankesën, merr vendimin përfundimtar dhe njofton aplikuesin me e-mail, brenda 5 ditëve pune nga marrja e ankesës.
10. Kohëzgjatja e vleftshmërisë së akreditimit të trajnimit është 5 vite.
11. Vendimi i KKM për akreditimin e trajnimit i përcillet zyrtarisht Drejtorit të Përgjithshëm të AKAFPK-së.
12. Drejtori i Përgjithshëm i AKAFPK-së i lëshon ofruesit të trajnimit që akreditohet, "Certifikatën e akreditimit të trajnimit" (shtojca 4) e cila përmban kodin, datën dhe kohëzgjatjen e vleftshmërisë së akreditimit, të dhënat që identifikojnë ofruesin e trajnimit dhe të dhënat për programin e trajnimit (titullin, vlerën e krediteve, emërtimin dhe kohëzgjatjen e temave/moduleve të trajnimit).
13. AKAFPK publikon në faqen zyrtare Listën e trajnimeve të akredituara si dhe informacionin bazë për çdo trajnim (kodin e akreditimit, vleftshmërinë, kontaktet e ofruesit, titullin e trajnimit, vlerën e krediteve, temat/modulet e trajnimit dhe kohëzgjatjet).
14. KKM mban procesverbal për shqyrtimin e aplikimit për akreditimin e trajnimit, si dhe për vendimin që i përcjell Drejtorit të Përgjithshëm të AKAFPK-së.
15. Personat që angazhohen në procesin e akreditimit të trajnimeve për mësimdhënësit e kulturës profesionale në AFP duhet të nënshkruajnë deklaratën për konfliktin e interesit

Neni 9

Përzgjedhja dhe realizimi i trajnimeve të akredituara për mësimdhënësit e kulturës profesionale në AFP

1. Mësimdhënësit e kulturës profesionale, duke filluar nga data e miratimit të këtij udhëzimi, bazuar në nevojat individuale për trajnim dhe në rekomandimet e Njesisë së Zhvillimit të ofruesit të AFP, mund të përzgjedhin trajnimin/trajnimet që dëshirojnë të ndjekin, vetëm nga Lista e trajnimeve të akredituara, të publikuar në faqen zyrtare të AKAFPK.
2. Mësimdhënësve të kulturës profesionale, të cilët kanë kryer trajnime të akredituara nga KAPT i MAS para datës së miratimit të këtij udhëzimi, do t'u njihen certifikatat dhe kreditet e fituara nga këto trajnime.
3. Mësimdhënësit kontaktojnë ofruesit e trajnimeve të akredituara dhe marrin informacionet e nevojshme për modalitetet e pjesëmarrjes në trajnimet që ofrojnë (përfshirë dhe tarifën e pjesëmarrjes, nëse ka).
4. Shpenzimet e pjesëmarrjes në trajnimet e akredituara përballohen nga pagesat e vetë pjesëmarrësve ose nga burime të tjera të ligjshme.

5. Mësimdhënësit e kulturës profesionale nuk mund të akumulojnë kredite nga i njëjti trajnim i akredituar, të cilin e kryejnë dy apo më shumë herë.
6. Ofruesi i trajnimit të akredituar duhet të njoftojë me e-mail në adresën zyrtare të AKAFPK, info@akafp.gov.al, jo më pak se 10 ditë pune para fillimit të trajnimit, për titullin, datat, oraret, vendin dhe/ose formatin e trajnimit, trajnerin/trajnerët dhe listën e pjesëmarrësve në trajnim.
7. Monitorues nga AKAFPK të cilët caktohen me urdhër të drejtuesit të AKAFPK-së të monitorojnë realizimin e trajnimit të akredituar (procesin dhe dokumentacionin) dhe përgatitin raportin e monitorimit për Drejtorin e Përgjithshëm të AKAFPK.
8. Nëse gjatë monitorimit evidentohen shmangie të theksuara nga kërkesat dhe kriteret për trajnimin e akredituar, Drejtori i Përgjithshëm i AKAFPK merr vendimin për anulimin e trajnimit, anulimin e akreditimit për këtë trajnim dhe heqjen nga lista e trajnimeve të akredituara.
9. Pas përfundimit të trajnimit të akredituar, ofruesi i trajnimit dërgon me e-mail në adresën zyrtare të AKAFPK info@akafp.gov.al, listën e mësimdhënësve që e përfundojnë me sukses trajnimin përkatës.
10. Ofruesi i trajnimit të akredituar i pajis pjesëmarrësit e suksesshëm në trajnim me Certifikatën e trajnimit e cila përmban emrin dhe mbiemrin e pjesëmarrësit, datat dhe kohëzgjatjen e trajnimit, të dhënat për programin e trajnimit (titullin, kodin, vlerën e krediteve, emërtimin dhe kohëzgjatjen e temave/moduleve), të dhënat për ofruesin e trajnimit (logon, firmën, vulën, nëse ka).

KREU V

PËRGJEGJËSITË, KRITERET DHE PROCEDURAT PËR PROVIMET E KUALIFIKIMIT TË VAZHDUAR PROFESIONAL TË MËSIMDHËNËSVE TË KULTURËS PROFESIONALE NË OFRUESIT E AFP

Neni 10

Testet e provimeve të kualifikimit për mësimdhënësit e kulturës profesionale në AFP

1. Provimet e kualifikimit për mësimdhënësit e kulturës profesionale në AFP zhvillohen me teste me shkrim.
2. Formatit, rubrikat, numri i njësive, pikëzimi dhe detaje të tjera të testeve të provimeve të kualifikimit përcaktohen nga KKM dhe publikohen në faqen zyrtare të AKAFPK.
3. Testet e provimeve të kualifikimit përgatiten çdo vit, të veçanta, sipas grupeve (pika 4 e nenit 2).
4. AKAFPK i përgatit testet e provimeve të kualifikimit me grupe bashkëpunëtorësh, specialistë me kontratë, të cilët përzgjidhen nëpërmjet procedurës së konkurimit të hapur.
5. Përgatitja, printimi dhe ruajtja e testeve të provimeve të kualifikimeve bëhet në përputhje me rregullat e fshehtësisë të cilat përcaktohen me rregullore AKAFPK.
6. Personat që angazhohen në përgatitjen, printimin dhe ruajtjen e testeve të provimeve të kualifikimeve duhet të nënshkruajnë deklaratën për konfliktin e interesit.

Neni 11

Administrimi i provimeve të kualifikimit për mësimdhënësit e kulturës profesionale në AFP

1. AKAFPK është përgjegjëse për procesin e administrimit dhe të mbikqyrjes së provimeve të kualifikimit për mësimdhënësit e kulturës profesionale në AFP.
2. Provimet e kualifikimit për mësimdhënësit e kulturës profesionale në AFP kryhen çdo vit kalendarik, deri në 5 korrik.
3. AKAFPK publikon në faqen zyrtare njoftimin për provimin e kualifikimit për mësimdhënësit e kulturës profesionale në AFP, jo më pak se 10 ditë pune para datës së provimit.
4. Njoftimi për provimin e kualifikimit përmban listën e mësimdhënësve të grupit dhe kategorisë përkatëse që do të kryejnë provimin, datën, orën, kohëzgjatjen dhe vendin ku do të zhvillohet provimi, si dhe informacione të tjera.
5. Mësimdhënësit pjesmarrës në provim paraqiten në mjedisin e provimit, me dokument identifikimi, të paktën 30 minuta para fillimit të provimit.
6. Para fillimit të provimit, administratorët e provimit u shpjegojnë pjesmarrësve procedurat dhe rregullat e provimit.
7. Regjistrimi i pjesmarrësve në provim, shpërndarja e testeve, mbledhja e testeve të plotësuara dhe ruajtja e tyre bëhet në përputhje me rregullat e fshehtësisë (sekretimit).
8. Provimi i kualifikimit zhvillohet në mjedise që plotësojnë kushte të përshtatshme (hapësirat, ndriçimi, temperatura, zhurmat) që mundësojnë zhvillimin korrekt të provimit dhe me distancën e nevojshme midis pjesmarrësve.
9. Gjatë zhvillimit të provimit, nuk lejohet komunikimi midis pjesmarrësve dhe përdorimi i mjeteve elektronike të komunikimit.
10. Për pjesmarrësit në provim që shkelin në mënyrë të dukshme rregullat e zhvillimit të provimit, administratorët e provimit vendosin përjashtimin nga provimi.
11. Në një mjedis provimi, nuk lejohet të zhvillojnë njëkohësisht provimin e kualifikimit më shumë se 15 mësimdhënës.
12. Nëse numri i mësimdhënësve në provimin e kualifikimit është më i madh se 15, bëhet ndarja në grupe dhe provimi zhvillohet në të njëjtën kohë në dy apo më shumë mjedise provimi.
13. Kohëzgjatja maksimale e provimit të kualifikimit është 1 orë e 30 minuta.
14. Në përfundim të provimit, administratorët e provimit plotësojnë procesverbalin e provimit, ku evidentohen aspektet kryesore të zhvillimit të provimit.
15. Punonjwsit e AKAFPK-së që angazhohen në procesin e administrimit dhe mbikqyrjes së provimeve të kualifikimeve duhet të nënshkruajnë deklaratën për konfliktin e interesit.

Neni 12

Vlerësimi i testeve të provimeve të kualifikimit për mësimdhënësit e kulturës profesionale në AFP dhe ankimi

1. Vlerësimi i testeve të plotësuara nga pjesëmarrësit në provimin e kualifikimit bëhet nga KKM, brenda 3 ditëve pune nga përfundimi i provimit të kualifikimit.
2. AKAFPK njofton individualisht me e-mail pjesëmarrësit lidhur me rezultatet e provimit të kualifikimit.
3. Çdo test, vlerësohet maksimalisht me 50 pikë.

4. Pjesëmarrësi në provim që fiton më pak se 25 pikë në testin e kualifikimit konsiderohet jo-fitues i provimit.
5. Pjesëmarrësit në provim mund të ankohen për rezultatin e vlerësimit të testit të kualifikimit, duke dërguar ankesën me e-mail dhe/apo me shkresë, në adresën përkatëse të AKAFPK, brenda 3 ditë pune nga shpallja e rezultatit.
6. KKM, brenda 3 ditë pune nga përfundimi i afatit të ankimit, shqyrton ankesat dhe njofton pjesëmarrësit për rezultatin përfundimtar të vlerësimit të testit.
7. Pjesëmarrësi në provim, i cili vlerësohet me më pak se 25 pikë në provim dhe shpallet jo-fitues i provimit të kualifikimit, nuk fiton kualifikimin përkatës, por ka të drejtë të rifutet në provim në vitet pasardhëse.
8. KKM mban procesverbal për rezultatet e vlerësimeve të testeve, si dhe rezultatet përfundimtare të testeve, pas ankimeve.
9. Personat që angazhohen në procesin e vlerësimit të testeve të provimeve të kualifikimeve duhet të nënshkruajnë deklaratën për konfliktin e interesit

KREU V

VLERËSIMI PËRFUNDIMTAR I KUALIFIKIMIT TË VAZHDUAR PROFESIONAL DHE CERTIFIKIMI I MËSIMDHËNËSVE TË KULTURËS PROFESIONALE NË OFRUESIT E AFP

Neni 13

Vlerësimi përfundimtar i kualifikimit për mësimdhënësit e kulturës profesionale në AFP

1. Vlerësimi përfundimtar i kualifikimit të kandidatëve, mësimdhënës të kulturës profesionale në AFP, bëhet nga KKM.
2. Vlerësimi përfundimtar i kualifikimit të kandidatëve bëhet me sistemin e 100 pikëve, nga të cilat maksimalisht 50 pikë fitohen nga vlerësimi i portofolit të kualifikimit dhe maksimalisht 50 pikë fitohen nga provimi i kualifikimit përkatës.
3. Totali i pikëve të fituara nga kandidati në kualifikim llogaritet si shuma e pikëve të fituara nga portofoli i kualifikimit dhe e pikëve të fituara nga provimi i kualifikimit.
4. Kandidatit që nuk plotëson dokumentacionin e detyrueshëm të portofolit të kualifikimit ose fiton më pak se 25 pikë me portofolin e kualifikimit, nuk i llogaritet shuma e pikëve dhe nuk e fiton kualifikimin për kategorinë përkatëse.
5. Kandidatit që fiton më pak se 25 pikë në provimin e kualifikimit, nuk i llogaritet shuma e pikëve dhe nuk e fiton kualifikimin për kategorinë përkatëse.
6. Referuar shumës së pikëve të fituara në kualifikim, kandidatët vlerësohen me 5 (pesë) shkallë: A, B, C, D, E që i korrespondojnë përkatësisht vlerësimeve me fjalët "Shkëlqyeshëm", "Shumë mirë", "Mirë", "Mjaftueshëm" dhe "Dobët", sipas Skemës së shkallëve të vlerësimit në Shtojcën 5.
7. Nëse shuma e pikëve të fituara në kualifikim është më e vogël se 50 pikë, vlerësimi përfundimtar është "Dobët" (shkalla "E") dhe kandidati nuk e fiton kualifikimin për kategorinë përkatëse.
8. AKAFPK njofton individualisht me e-mail kandidatët pjesëmarrës në kualifikim për rezultatet e vlerësimit të kualifikimit të kryer prej tyre.

9. Kandidatët pjesëmarrës në kualifikim mund të ankohen për rezultatin e vlerësimit të kualifikimit, duke dërguar ankesën me e-mail, në adresën zyrtare të AKAFPK, brenda 3 ditë pune nga shpallja e rezultatit.
10. KKM, brenda 5 ditë pune nga përfundimi i afatit të ankimit, shqyrton ankesat dhe njofton kandidatët për rezultatin përfundimtar të vlerësimit të kualifikimit për kategorinë përkatëse.
11. Kandidati pjesëmarrës në kualifikim që kërkon të përmirësojë rezultatin e kualifikimit (shkallën e arritur), mund t'i bëjë kërkesë (me e-mail) AKAFPK për tu rifitur në provimin e kualifikimit vetëm vitin e ardhshëm dhe në këtë rast, për vlerësimin përfundimtar, do të llogariten pikët e fituara në riprovim.
12. Pas vlerësimit përfundimtar të kandidatëve pjesëmarrës në kualifikim, AKAFPK dërgon zyrtarisht në AKPA listën emërore të mësimdhënësve pjesëmarrës në kualifikim, kategoritë e kualifikimit të fituara dhe shkallët e vlerësimeve të arritura.
13. Personat që angazhohen në procesin e vlerësimit përfundimtar të kualifikimeve për mësimdhënësit e kulturës profesionale në AFP, duhet të nënshkruajnë deklaratën për konfliktin e interesit

Neni 14

Certifikimi i kualifikimit për mësimdhënësit e kulturës profesionale në AFP

1. AKAFPK, brenda 10 ditë pune nga shpallja e rezultateve përfundimtare të kualifikimit bën certifikimin e kandidatëve që kanë kryer me sukses të gjithë procedurën e kualifikimit (atestimit) për kategorinë përkatëse.
2. AKAFPK prodhon certifikatat e kualifikimit për të gjithë kandidatët që kanë fituar kategorinë përkatëse të kualifikimit.
3. Certifikata e kualifikimit duhet të përmbajë këto të dhëna: logon e AKAFPK, numrin e regjistrimit të certifikatës, emrin dhe mbiemrin e mësimdhënësit, kategorinë e kualifikimit të fituar, shkallën e vlerësimit me shkronjë, të shoqëruar me përshkrim, datën e certifikimit, emrin dhe firmën e Drejtorit të Përgjithshëm, si dhe vulën e AKAFPK.
4. AKAFPK dërgon me postë certifikatat e plotësuara, në adresat e ofruesve të AFP ku mësimdhënësit janë të punësuar.
5. AKAFPK dërgon në AKPA listën përfundimtare të mësimdhënësve të kulturës profesionale së bashku me rezultatet/kategorinë e kualifikimit përkatës të fituar.
6. AKAFPK mban regjistrin e certifikatave të kualifikimit, të fituara nga mësimdhënësit kulturës profesionale të AFP, pas miratimit të këtij udhëzimi.

KREU VI

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 15

Ruajtja e dokumentacionit të kualifikimit të mësimdhënësve të kulturës profesionale në AFP.

1. Dokumentacioni i krijuar gjatë zbatimit të procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim ruhet në arkivat e institucioneve përkatëse, AKAFPK, AKPA dhe ofruesit e AFP, në përputhje me ligjin për arkivat në Republikën e Shqipërisë.

2. Dokumentacioni në format elektronik ruhet në arkivin elektronik të institucioneve përkatëse.
3. Për certifikatat e trajnimeve të akredituara të kryera sipas Neni 5 pika 3/b, vetëm për kategorinë “Mësues mjeshtër” duhen:
 - a) të paktën 7 kredite trajnimi të akredituara në vitin 2022
 - b) të paktën 8 kredite trajnimi të akredituara në vitin 2023
 - c) të paktën 9 kredite trajnimi të akredituara në vitin 2024

Neni 16
Dispozita kalimtare

1. Afatet kohore për procedurat e kualifikimit që përcaktohen në këtë udhëzim, i referohen kualifikimeve të mësimdhënësve duke filluar nga vitit 2023 e në vijim.
2. Për afatet kohore që lidhen me kualifikimet e mësimdhënësve për vitin 2022, AKAFPK informon shkollat profesionale me anë të një udhëzuesi të posaçëm.

Neni 17
Zbatimi i udhëzimit dhe hyrja në fuqi

Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi, Ministria Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Politikave të Punësimit dhe Aftësimit Profesional në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe e Kualifikimeve, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Ofruesit e AFP.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet ë Fletoren Zyrtare

MINISTRI

Delina IBRAHIMAJ



SHTOJCA 1

FORMATI I JETËSHKRIMIT

Europass Curriculum Vitae

Vendosni fotografinë.

Informacion Personal

Emri / Mbiemri

Emri Mbiemri

Adresa

Numri i shtëpisë / apartamentit, emri i rrugës, kodi postar, qyteti, shteti

Telefoni(at)

Fiks:

Celular:

Fax

E-mail

Shtetësia

Data e lindjes

Gjinia

Punësimi i dëshiruar / Fusha e punësimit

Eksperiencat e punësimit

Vendosni dhe shtoni informacione të veçanta për secilën punë të kryer në të kaluarën, duke filluar nga ajo e fundit.

Data

Roli ose pozicioni i punës

Aktivitetet kryesore dhe
përgjegjësitë

Emri dhe adresa e
punëdhënësit

Lloji i biznesit ose sektori

Arsimi dhe trajnimet

Vendosni informacione të veçanta për secilin kurs apo trajnim të kryer në të kaluarën, duke filluar nga ajo e fundit.

Data

Titulli i kualifikimit të arritur

Informacion shitesë Shtoni këtu çdo informacion tjetër që mund të jetë i vlefshëm, si p.sh.: persona kontakti, referenca, etj. (Hiqeni nëse nuk është e vlefshme, shihni udhëzimet)

Anekse Listoni materiale ose dokumente të bashkangjitura me CV-në. (Hiqeni nëse nuk është e vlefshme, shihni udhëzimet)

SKEMA E VLERËSIMIT TË PORTOFOLIT TË KUALIFIKIMIT
të mësimdhënësve të kulturës profesionale në AFP

Tabela 1: Llogaritja e pikëve nga elementet e Portofolit të kandidatit.

Nr	Elementi i Portofolit	Kriteret e vlerësimit	Pikët për çdo kriter	Pikët maksimale
1	Plan i mësimdhënies së lëndës teorike ose modulit praktik	Rubrikat e planit të mësimdhënies sipas formatit	1÷2	10
		Përmbajtjet në koherencë me programin e lëndës ose përshkruesin e modulit	1÷4	
		Variacion metodash dhe në koherencë me përmbajtjet	1÷4	
2	Plan – ditar i një seance teorike ose praktike	Rubrikat e plan-ditarit janë të plota	1÷2	9
		Fazat e mësimit sipas parimeve didaktike	1÷4	
		Variacion metodash në koherencë me përmbajtjet	1÷3	
3	Formulim i një objektivi mësimor specifik, teorik ose praktik	Objektivi i plotë, me të tre elementet	1	2
		Elementet e objektivit në koherencë me njëri-tjetrin	1	
4	Test teorik (jo më pak se 5 njësi) ose Listë kontrolli (jo më pak se 5 kriteret vlerësimi)	Testi me 5 njësi/Lista e kontrollit me 5 kriteret	1	6
		Variacion i njësisve të testit/koherencë e kriterëve të listës	1÷2	
		Njësitë e testit janë korrekte/kriteret e listës të formuluar drejt	1÷3	
5	Material mësimor teorik (1 fq.A4) ose Udhëzues pune për aftësi praktike	Formati i materialit mësimor/Struktura e udhëzuesit	1	5
		Ilustrimet e materialit mësimor/renditja e hapave të udhëzuesit	1÷2	
		Përmbajtja e materialit mësimor/përmbajtja e udhëzuesit	1÷2	
6	Prezantim në PoëerPoint për aspekte teorike ose praktike (jo më pak se 3 slajde)	Formati, ilustrimet, efektet e prezantimit	1÷2	4
		Përmbajtja e prezantimit	1÷2	
7	Trajnime të akredituara (shitesë) ose të pa-	Trajnime me kohëzgjatje 6 – 18 orë	4	6

	akredituara, të kryera gjatë periudhës së kualifikimit	Trajnime me kohëzgjatje 6 – 30 orë	5	
		Trajnime me kohëzgjatje më shumë se 30 orë	6	
8	Dëshmi të gjuhëve të huaja (të mbrojtura në IAL ose në teste ndërkombëtare)	Një gjuhë e huaj	4	8
		Dy gjuhë të huaja	6	
		Më shumë se dy gjuhë të huaja	8	
Pikët maksimale				50

Tabela 2: Pikë shtesë (bonuse)

Nr	Elementi i Portofolit	Kriteret e vlerësimit	Pikët për çdo kriter	Pikët maksimale
1	Tituj/gradat shkencore	Doktor	2	4
		Profesor i asociuar	3	
		Profesor	4	
2	Bashkëpunëtor (specialist me kontratë) i AKAFPK	Të paktën një kontratë me AKAFPK	2	2
3	Stazh (praktikë) në një institucion ose biznes, në fushën profesionale përkatëse	Të paktën 3 ditë stazh (praktikë), në dy vitet e fundit	4	4

Shënime:

- Pikët maksimale që fitohen nga vlerësimi i portofolit të kualifikimit (Tabela 1), janë 50 pikë.
- Kur kandidati nuk i plotëson pikët maksimale (50 pikë) nga vlerësimi i portofolit (Tabela 1), mund të fitojë pikë shtesë (bonuse) nëse plotëson kriteret e Tabelës 2. Shuma e pikëve nga Tabela 1 dhe Tabela 2, nuk duhet të kalojë 50 pikë.
- Nëse kandidati fiton më pak se 25 pikë nga vlerësimi i portofolit të kualifikimit dhe nga bonuset, përjashtohet nga procedura e mëtejshme e kualifikimit.

FORMATI I KËRKESËS PËR AKREDITIM TË TRAJNIMIT

Logo e subjektit
Emërtimi i subjektit

Kërkesë për akreditim të trajnimit/trajnimeve.

Datë,

Drejtuar: Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Tiranë

Unë,, përfaqësues i subjektit, me adresë, telefon, email....., referuar Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Nr....., datë2022, "Për Kualifikimin e Vazhduar Profesional të mësimdhënësve të kulturës profesionale në Arsimin dhe Formimin Profesional", parashtroj kërkesën për akreditim të trajnimit (trajnimeve) të mëposhtëme:

1.
2.
3.

Bashkangjitur ndodhet edhe dokumentacioni i kërkuar:

1. Të dhënat e subjektit.
2. Dokumentacioni juridik për subjektin.
3. Dokumentacioni i programit të trajnimit/trajnimeve.
4. Dokumentacioni për shkallën e kualifikimit të trajnerëve.
5. Dokumentacioni për infrastrukturën fizike dhe didaktike të realizimit të trajnimit

Duke shpresuar në miratimin e kësaj kërkesë,

Me respekt,

Emër, mbiemër, firma dhe vula e subjektit (nëse ka)

FORMATI I CERTIFIKATËS SË AKREDITIMIT TË TRAJNIMIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE

CERTIFIKATË E AKREDITIMIT TË TRAJNIMIT

Mbështetur në vendimin e Komisionit për Kualifikimin e Mësimdhënësve të AFP, nr....., datë....., subjekti akreditohet për ofrimin e trajnimit për mësimdhënësit e kulturës profesionale në Arsimin dhe Formimin Profesional, me titull:, me kohëzgjatje kredite (... orë trajnimi).

Programi i trajnimit të akredituar

Nr	Temat/modulet e trajnimit	Kreditet	Orët e trajnimit
1
2
3

Kodi i akreditimit:

Nr. i regjistrimit:

Datë

Kjo certifikatë akreditimi është e vlefshme për një afat vjeçar.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

(Emri, mbiemri, firma, vula)

SKEMA E SHKALLËVE TË VLERËSIMIT
Për Kualifikimet e Mësimdhënësve të Kulturës Profesionale në AFP

Shuma e pikëve të fituara nga portofoli + testi	Vlerësimi me shkallë	Vlerësimi me shprehje
0 ÷ 49	E	Dobët
50 ÷ 62	D	Mjaftueshëm
63 ÷ 75	C	Mirë
76 ÷ 88	B	Shumë mirë
89 ÷ 100	A	Shkëlqyeshëm

Shënime:

- Pikët maksimale që fitohen nga shuma e pikëve të fituara nga portofoli i kualifikimit dhe nga testi i provimit të kualifikimit, janë 100 pikë.
- Nëse kandidati fiton më pak se 25 pikë nga vlerësimi i portofolit të kualifikimit, nuk e fiton kategorinë e kualifikimit, pavarësisht nga totali i pikëve të fituara.
- Nëse kandidati fiton më pak se 25 pikë nga vlerësimi në testin e provimit të kualifikimit, nuk e fiton kategorinë e kualifikimit, pavarësisht nga totali i pikëve të fituara.
- Nëse kandidati grumbullon më pak se 50 pikë nga shuma e pikëve të fituara nga portofoli dhe nga testi, vlerësohet me shkallën "E" (Dobët) dhe nuk e fiton kategorinë e kualifikimit.